



TË DHËNAT PËR ASETIN

Shitja e Aseteve përmes Likuidimit Nr.73

Njësia e Vendosur në Tender Nr.29


NPB Malishgan-Parcelat nr.636-3 dhe 636-4 në ZK Jashanicë

Emri i NSh.-së	NPB Malishgani, Klinë
Lloji i Shitjes	Shitje përmes Likuidimit me ofertë të mbyllur
Dita e Ofertimit	25.06.2025 nga ora 10:00h deri 12:00h në Sallën e Konferencave të "HOTEL GRAND" në Prishtinë
Çmimi Minimal	1,350€/ari
Depozita e Ofertës	€ 9,000
Kategoria potenciale për shfrytëzim	Rezidenciale
<u>Përshkrimi i Aseteve</u>	
Vendndodhja e Aseteve	Zona Kadastrale Jashanicë, Komuna e Klinës. Të dhënat e hartës ©2024 Google Shikoni këtë pronë në Google Maps 1 Shikoni këtë pronë në Google Maps 2 Aktmohim: Vendndodhjet e treguara nga PIN-at në Google Maps ofrohen vetëm për qëllime të orientimit dhe referencës së përgjithshme. Këto mund të mos pasqyrojnë saktësisht vendndodhjen, kufijtë ose veçori të tjera të asetëve të përshkruara. Përdoruesit këshillohen të verifikojnë në mënyrë të pavarur të gjitha vendndodhjet për çdo çështje që kërkon saktësi ose informacion me rëndësi ligjore. Kjo shitje përfshinë parcelën nr.636-3 me kulturë Arë e klasës 4 në sipërfaqe prej 58ari 30m² (5830m²) dhe parcelën nr. 636-4 me kulturë Livadh i klasës 5 në sipërfaqe prej 662m², në sipërfaqe të përgjithshme 6492m² (64 ari 92m²) që ndodhen në Zonën Kadastrale Jashanicë, komuna e Klinës. Në anën perëndimore parcelat kufizohen me P.sh ujërat ndërsa në anën lindore kufizohen me rrugë publike. Toka është e punuar.
Ndërtesat dhe tokat	Nuk ka ndërtesë në këtë shitje.
Shfrytëzuesit	Aktualisht nuk ka marrëveshje për qira.
Asetet tjera	Nuk ka.
Detyrimet që do të barten	Asnjë nga detyrimet nuk do të barten tek blerësi i ri, por sidoqoftë blerësi potencial duhet të ketë parasysh se mund të jetë i aplikueshëm tatimi për bartjen e pronës.



Foto/fotot

ose informata të tjera
për asetet në shitje



Informatat rreth Njesisë lëndë e shitjes të prezantuar në Te Dhëna nuk janë të garantuara. Investitorët potencial inkurajohen të kontaktojnë Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP) për të kërkuar dokumentet e tenderit. Ata të cilët dëshirojnë të paraqesin ofertë duhet të llogarisin në hulumtimet e tyre. Investitorët potencial këshillohen të bëjnë verifikimin e të dhënave vet para se të paraqesin ndonjë ofertë ose propozim për tender. Këto të Dhëna janë në dispozicion nën kushtet e përgjithshme në informatat paraprake për informacione të publikut të gjerë për kandidatët e privatizimit, e cila mund të nxirret nga faqja e internetit të AKP-së: www.pak-ks.org.



Raporti i vizitës në terren



RAPORT I VIZITËS NË TERREN

NPB MALISHGANI- Parcelat kadastrale me nr. 636-3 & 636-4 ZK Jashanicë

Me datë 19.03.2025 zyrtarët e AKP ZR Pejë prezent në terren ishim unë Blerta Jashari Kastrati Zyrtare kadastrale dhe Lindita Agushi Zyrtare e operacioneve për administrim të aseteve për identifikimin e tokës e cila sipas certifikatës së pronës evidentohet në pronësi të "NPB MALISHGANI" ZK Jashanicë, Komuna Klinë.

Toka është e regjistruar në certifikatën e pronësisë me nr të njësisë P-71006021-636-3 me sipërfaqe prej 5830m² me kulturë Arë e klasës 4 1/1, P-71006021-636-4 me sipërfaqe prej 662m² me kulturë Livadhi klasës 5 1/1 në vendin e quajtur "Jashanica e Ulët, me sipërfaqe të përgjithshme 6492m².



Fig. 1 Ortofoto & Fotografia e terrenit për parcelat me nr. 636-3, 636-4 ZK Jashanicë

Nga vizita në teren konstatojmë këtë gjendje:

- Parcelat kadastrale me nr të njësisë 636-3, 636-4 shtrihen në jug të zonës kadastrale Jashanicë.
- Gjendja faktike e tokës në terren përputhet me gjendjen kadastrale juridike.
- Brenda parcelës me nr. 636-3 ekziston shtyllë elektrike (prej druri).
- Në anën perëndimore parcelat kufizohen me PSh Ujrat.
- Në anën lindore parcelat kufizohen me rrugë publike.
- Është e punuar.

Zyrtare Kadastrale Rajonale:

Blerta Jashari-Kastrati

Zyrtare e operacioneve për administrim të aseteve:

Lindita Agushi

Informatat dhe

Dokumentet e Ofertimit

Divizioni i Marketingut dhe Tenderit Publik

Tel: +383 (0) 38 500 400 lok.1090, 2059

www.pak-ks.org

Agjencia Kosovare e Privatizimit

Rr. Dritan Hoxha, nr.55

10000 Prishtinë, Republika e Kosovës